



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
SP-052
Prishtinë, më 14 dhjetor 2018

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 DHJETOR 2018**

Seancën plenare e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Në fillim të seancës, me propozim të kryetarit, Kuvendi mbajti një minutë heshtje për të gjithë brezat, të cilët në kohë dhe rrethana të ndryshme kanë sakrifikuar për çlirimin e Kosovës dhe krijimin e institucioneve shtetërore.

Pastaj, kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, si në vijim:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Ministrinë e Mbrojtjes

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haxhi Shala, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 11 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim në formë elektronike, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional.

Kuvendi i miratoi amendamentet nga 1 deri 11.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 106,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haxhi Shala, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 45 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim në formë elektronike, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi amendamentet nga 1 deri 45.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 107,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haxhi Shala, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 45 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim në formë elektronike, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi amendamentet nga 1 deri 45.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 107,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-124 për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në fund, kryetari i Kuvendit i uroi komandantët dhe kadetët e FSK-së që ishin të pranishëm dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për formimin e Ushtrinë së Kosovës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*